



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-21877
Datë: 07.11.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Shërbime të Përbashkëta, me datë 07.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

Nëpunësi **Hysen Brahimaj**, i sistemuar në punë Zyrtar i Lartë për Arsim në kuadër të Drejtorisë për Arsim, **caktohet ushtrues i detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime të Përbashkëta**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit 7.26 (GJ3) duke filluar nga data **08.11.2023**.

1. I emëruari si në pikën 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - 1.1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
 - 1.2. Menaxhon me stafin e sektorit dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore.
 - 1.3. Ndhmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë.
 - 1.4. Menaxhon dhe organizon punën e zyrtarëve për ndërtimtari dhe infrastrukturë, zyrtarëve ligjor, zyrtarëve për statistika, zyrtarëve të pasurisë dhe zyrtarëve për buxhet dhe financa në kuadër të Drejtorisë për Arsim.
 - 1.5. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
 - 1.6. Siguron koordinimin e aktiviteteve me sektorët tjerë të Komunës së Gjakovës për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
 - 1.7. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
2. Shfuqizohet vendimi i Kryetarit të Komunës numër 01-112/02-16666 i datës 24.08.2023.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Hysen Brahimaj
- Drejtorisë për Arsim
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

